



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 4 DHJETOR 2009**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
4. DECEMBRA 2009. GODINE**

**DHJETOR – DECEMBAR
2009**

Seancën e kryesoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë momentalisht janë të pranishëm 48 deputetë dhe janë të plotësuar kushtet për të ia filluar seancën me pikën e parë të rendit të ditës me pyetjet e deputetëve.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare. Me që për pikën e pestë të rendit të ditës nuk janë siguruar dokumente shtesë, propozoj, se kështu ka qenë edhe marrëveshja në Kryesi, që kjo çështje të shtyhet për seancën e radhës. Pra, pika e pestë e rendit të ditës nuk do të shqyrtohet sot.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës

- Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 19, 20 e 23 nëntor 2009

A ka dikush vërejtje në këto procesverbale?

Zoti Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

E kam një vërejtje të vogël për administratën. E kanë bërë një lëshim, është në faqen 2, ku u thuhet se Driton Tali parashtoi pyetjen për kryeministrin, zëvendëskryeministrin lidhur me memorandumin për implementimin e projektit, e tjera, tjera. Nuk është bërë kjo pyetje, nuk qëndron as në transkript. Flas për procesverbalin e seancës 19 nëntor, andaj kisha kërkuar nga administrata që ta heqë këtë, për shkak se kjo pyetje shpresoj se sot do të bëhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Regjia e ka regjistruar, kërkoj nga administrata ta ketë parasysh kërkesën e deputetit Tali dhe ta harmonizojë me vërejtjet që i ka dhënë.

Atëherë, tjera vërejtje nuk ka, konstatoj që Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 19, 20, dhe 23 nëntor 2009.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Pyetja e parë është e shtruar nga deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi ose ministren Justina Pula- Shiroka. Ata nuk janë këtu. A dëshironi ta lexoni pyetjen, zotëri Tali, me qenë se nuk janë momentalisht prezentë as Kryeministri as ministrja në fjalë? Pyetja 1803 e regjistruar. Zoti Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Zoti kryesues, kjo pyetje është bërë në seancën e parakaluar, siç po shihet këtu është edhe ajo komplikimi tek administrata. Kjo pyetje është bërë, sidoqoftë. Faleminderit!

KRYESUESI: Kërkoj falje, në emër të administratës me qenë se më takon, nëse është kështu. Pyetja e dytë është prapë e deputetit Driton Tali, pyetje për Kryeministrin, Hashim Thaçi, zëvendëskryeministrin ose për ministrin Ahmet Shala, e shtruar më 29.10.2009, dokumenti 1805, pyetja, domethënë. Zoti Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Po faleminderit, zoti kryesues!

Siç po shihet, administrata ka probleme sidoqoftë, pyetja është ripërtërirë.

Çështja është kjo. Kohë më parë, Qeveria me PTK-n nënshkroi Memorandumin për implementimin e projektit për 80 milionë euro për informatizimin dhe kompjuterizimin e të gjitha institucioneve shkollore. Ky memorandum është shkruar para shtatë muajve edhe deri më tani opinionin e gjerë kosovar nuk ka dëgjuar asgjë lidhur me këtë projekt se në cilën fazë është, pos asaj se Kryeministri pat deklaruar se është një projekt i shkëlqyeshëm, andaj, pyetja ime është se në cilën fazë është ky projekt? Pyetjen ja drejtoj zotit ministër të Ekonomisë dhe Financave, apo edhe zëvendëskryeministrit, cilido. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Shala, e keni fjalën, në qoftë se jeni të përgatitur për përgjigje.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar kryesues,
I nderuar zëvendëskryeministër, të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
I nderuar deputet Tali,

Në bazë të informacioneve që kam nga menaxhmenti dhe Bordi i Postë-Telekomunikacionit të Kosovës dhe duke iu referuar pyetjes suaj lidhur me fiber to school, pra lidhje me internet të shkollave në Kosovë, pas nënshkrimit të memorandumit midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe PTK-së për implementimin e projektit për informatizim dhe kompjuterizim të gjitha institucioneve shkollore, PTK-ja ka marrë përsipër zbatimin e projektit. Dhe, më lejoni t'ju njoftoj se projekti i informatizimit është në procedurën e prokurimit, gjegjësisht në fazën e përzgjedhjes së kompanive sipas Ligjit të prokurimit të Republikës së Kosovës, që do të thotë, para vlerësimit e që së shpejti besoj që rezultatet do të referohen dhe informohen për publikun dhe për Qeverinë. Këto janë informata që unë i kam marrë nga Bordi i Postë-Telekomunikacionit të Kosovës, përkatësisht të kompanisë publike dhe këto i paraqita para jush. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

A keni pyetje shtesë, zoti Tali?

DRITON TALI: Zoti ministër, ngase Qeveria ka qenë në mënyrë direkte e involvuar, mendoj se është dashur të jeni më thuktë të involvuar aty. Unë po e cek atë që është premtuar, është premtuar se në muajin e ardhshëm, domethënë, në qershor, pra para 5 muajve të fillojë ky projekt dhe të përfundojë kah fundi i këtij viti. Siç po shihet, këtë projekt më së miri e shpjegon ai slogan i juaj:” premtuat, nuk e realizuat, dështuat”

KRYESUESI: A keni diçka për të thënë, zoti Shala? Okej.

Pyetja tjetër, sipas radhës është e deputetit Riza Smaka, pyetje për ministrin Zenun Pajaziti, apo ministrin Sadri Ferati, pyetja është e dorëzuar më 11 nëntor 2009, dokumenti i protokolluar 1832. Zoti Smaka, a dëshironi ta merrni fjalën, me qenë se nuk janë ministrat përkatës?

Zoti Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Faleminderit!

Zotëri kryesues,

I nderuar zëvendësministër,

Të nderuar ministra deputetë,

Çështja e adresave në vendin tonë, në përgjithësi, ndërsa në kryeqytet në veçanti, është mjaftë problemore. Filluar nga viti 1999, emërtimet e lokaliteteve, të lagjeve e veçanërisht të rrugëve, madje edhe të ndërtesave janë emërtuar, riemërtuar, e ashtu vijon një stih i rinominimeve të tyre, së andejmi qytetari, banori respektiv e aq më pak zyrtari po thuhet se asnjëherë nuk është i sigurt për emrin zyrtar të lagjes, të rrugës, e herë- herë të ndërtesës ku jeton, përkatësisht ku adresohet dokumenti i caktuar. Po thuhet se gjendje e ngjashme konsiston edhe me emërtimet e disa qyteteve. Çështja është: Pse nuk është bërë ajo që ka mund të bëhet edhe duhet medoemos të bëhet, sepse kjo është shumë e rëndësishme, jo veç për orientimin ordiner, por edhe për funksionimin e zyrtar të dokumenteve, të qarkullimeve, të komunikimeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Smaka!

Unë dua ta shfrytëzoj foltoren, me qenë se është në transmetim që t’i ftoj deputetët që nuk janë në sallë, që të paktën deri në fund të pikës së parë të rendit të ditës të vijnë ose do të mbesim pa kuorum.

Pyetja e katërt është e deputetit Riza Smaka, pyetje për ministrin Fatmir Limaj, dokumenti 1833. A dëshironi ta merrni fjalën edhe për këtë?

Zoti Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Po, shpeshherë këtu janë formalizuar këto pyetje se zakonisht edhe s’po marrim përgjigje, së pakut jo adekuate. Po e lexoj për hir të evidencës. Sipas të dhënave gjatë këtij viti kompanitë e sigurimeve kanë bërë ngritje të paarsyeshme të tarifave të sigurimeve të automjeteve. Sipas të dhënave disponuese i kam këtu fusnotat edhe i kam komentet,

ngritja e tarifave të sigurimeve të automjeteve e kap shkallën prej 27%. Ndryshe, organizimi dhe funksionimi i kompanive të sigurimeve aktualisht bazohet në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/25 për kompanitë e sigurimeve, dispozitat e së cilës do të preferohej të rishikoheshin dhe të modifikoheshin në përshtatje me realitetet ekzistente, por edhe me cedimin e disa autorizimeve ligjore në favor të MTT-së. Pyetja është, ju lutem: - Pse lejohet monopoli i tregut në bazë të.....

KRYESUESI: Edhe një minutë, ju lutem.

RIZA SMAKA: Me qenë se zotëri kryesues nuk ka as përgjigje, nuk mund të pritet, po brengosja është kjo, ju lutem. Kompanitë e sigurimeve kanë pozitë monopoliste në tregun kosovar dhe ato bëjnë marrëveshje monopoliste asisoj që e dëmtojnë qytetarin e taksapaguesin. Prandaj, kjo dukuri është e shëmtuar, e dëmshme për ekonominë e tregut edhe për qytetarin edhe kjo punë do të mund të kryhej shumë lehtë, vetëm kërkon dedikim minimal të një ministrie përkatëse. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Pyetja e pestë është e deputetes Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin Zenun Pajaziti, evidentuar 1836, dokumenti. A dëshironi ta merrni fjalën?

Gjylnaze Syla e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

Me qenë se konsideroj se ministri duhet të përgjigjet në pyetjen time, unë do ta pres ministrin Pajaziti të vijë, por njëkohësisht shfrytëzoj nga rasti që Kryesia të sigurojë që ministri të jetë në seancën e radhës, sepse është e treta herë që i bëj pyetje edhe ministri nuk është këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj që ju ka dëgjuar edhe ai.

Deputetja Qamile Morina, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj, dokumenti 1845.

A dëshironi ta merrni fjalën, deputete?

Deputetja Qamile Morina e ka fjalën.

QAMILE MORINA: Besoj që zëvendëskryeministri do të mund të përgjigjej, kështu që do ta bëjë pyetjen.

Në Mitrovicë, andej lumit Ibër, që pas lufte, fëmijët e lagjes Kodra e Minatorëve ndjekin mësimin në kontejner. Një pjesë tjetër në paralelet e ndara në shkollën "Aziz Sylejmani" dhe pjesa më e madhe udhëtojnë në pjesën jugore të qytetit për ta ndjekur mësimin. E drejta e këtyre fëmijëve dhe nevoja e ndërtimit të shkollës filllore në veri e në veçanti në Kodrën e Minatorëve, është e pakontestueshme, ngase edhe pas 10 vjet lirie ndjekin mësimin në kontejner.

Projekti dhe ndarja e buxhetit në vlerë prej 80.000 eurove është bërë për ndërtimin e kësaj shkolle, por kurrë nuk është realizuar. Gjithashtu, në prill të këtij viti ka pasur

iniciativa nga shkolla “Nonda Bulka”, në bashkëpunim me Qeverinë japoneze, zoti Suda Hiroshi, si donator drejtuar kuvendit komunal që të ndërtohet shkolla 5 – klasëshe në Lagjen e Boshnjakeve, te ura lindore në truallin e kuvendit komunal...

KRYESUESI: Edhe një minutë shtojani kohën deputetes, ju lutem!

...ju faleminderit! Edhe kjo dështoi. Sa e konsideroni dështimin e Ministrisë së Arsimit për mosrealizimit e këtyre projekteve vitale për fëmijët e Mitrovicës? Nëse jo, çka keni ndërmarrë ju, konkretisht, që të bëhet realitet shkolla fillore për këta fëmijë?

KRYESUESI: Zoti zëvendëskryeministër, është thirr në ju. Dëshironi të përgjigjeni apo rezervoheni kur të vjen ministri në fjalë. Ju faleminderit! E presim përgjigjen e ministrit.

Deputeti Riza Smaka, pyetje ministren Justina Shiroka Pula, dokumenti është 1851. Dëshironi ta lexoni pyetjen, meqenëse ministrja nuk është këtu. Zoti Riza Smaka e ka fjalën!

RIZA SMAKA: Do t’i përflas shkurtimisht, i nderuari kryesues. Brengosja i është referuar “Termokosit”, ndërmarrje publike, e cila nuk kryen shërbime cilësore as të rregullta, ndërsa i trazon qytetarët, konsumatorët me faturime të rregullta, madje të fryra, dhe në reagimet e qytetarëve, të konsumatorëve nuk reagon, si bie fjala, nuk dërgon komision për të konstatuar, bie fjala, se objektet e caktuara nuk kanë pasur asnjëherë ngrohje, po e zëmë, ose kanë pasur tepër të ulët. Shikoni, tash është në pyetje trazimi i panevojshëm, i paarsyeshëm i qytetarëve me faturime dhe me paditje. Kjo është një çështje që duhet të rregullohet, ju lutem, çështje që nuk përfillet ligji, aty është puna. Prandaj, i adresohem Ministrisë me këtë shqetësim që të ndërmarrë atë që...

KRYESUESI: Ju faleminderit! I autorizuar ose në emër të ministrisë dhe të Qeverisë, ministri Ahmet Shala i përgjigjet pyetjes suaj. Zoti Shala, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar profesor Smaka, i nderuar deputet, Ndërmarrja publike “Termokos”, është ndërmarrje komunale nga 15 qershori i vitit 2008. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin mbi ndërmarrjet publike, ndërmarrja “Termokos” është ndërmarrje komunale dhe kompetencat për veprimtarinë e saj i ka Bordi i ndërmarrjes publike “Termokos”, i cili përfaqësohet ose delegohet nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, kështu që desha vetëm të sqaroj për opinionin dhe për të tjerët se përgjegjësinë për ndërmarrjet publike komunale e kanë komunat dhe jo më ministrinë qendrore. Andaj, natyrisht që Ministria do ta përkrahë çfarëdo projekti i cili shkon në shërbim të qytetarëve të Kosovës, por konsideroj që adresa do të duhej të ishte në Komunën e Prishtinës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Shala! Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar. Pyetja është evidencuar në dokumentin 1852. Zoti Smaka, e keni fjalën!

RIZA SMAKA: Nëse më lejohet, me zotëri Shalën.

Zotëri ministër, Shala. Në doktrinë ekziston kjo zgjidhje, përgjegjësia në një binar dhe në binarët e dyfishtë. Në këtë rast, pikërisht ju kam drejtuar Qeverisë sonë, Ministrisë respektive, sepse ka ingerenca ligjore për të ndërmarrë masa të caktuara. Ju lutem, është çështje teorie e qartë kjo dhe, natyrisht, kur është në teori, nuk mund të jetë në kolizion as me dispozitat e rendit juridik. Është fjala te autoriteti politik që, fundi i fundit, është shqetësim makro dhe Qeveria nuk mund të jetë indiferente dhe, natyrisht, do të interferonte në mënyrë të caktuar në procedurë të caktuar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Po, zoti Shala e ka fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar profesor, i nderuar deputet, Nuk qëndron ajo, më fal, që po e thoni. Natyrisht, në qoftë se gjithmonë adresohet përgjegjësia politike, e përgjegjësinë politike konsideroj e kanë ata që e udhëheqin shtetin. Por, në këtë rast, ndërmarrja publike “Termokos” është kompetencë, që një vit e gjysmë e më tepër është kompetencë e Komunës së Prishtinës. E gjithë përgjegjësia e menaxhimit bie në Bordin e saj, Bordi zgjidhet, udhëhiqet dhe jep përgjigje Kuvendit Komunal të Prishtinës.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pra, vazhdojmë me pyetjen paraprake të deputetit Riza Smaka për ministrin Mahir Yagcilar.

RIZA SMAKA: I nderuar zoti kryesues,

Zoti ministër Yagcilar,

Në vendin tonë praktikisht mungon infrastruktura ligjore adekuate për parqet nacionale dhe për zonat e mbrojtura. Së andejmi, praktikisht nuk kemi parqe nacionale, nuk kemi zona të mbrojtura, të cilat padyshim janë të dobishme, në radhë të parë për ambientin jetësor, si dhe për ekonominë e vendit në përgjithësi.

Zotëri ministër, çfarë është opiniononi zyrtar i Ministrisë për Ambient dhe Planifikim Hapësinor, përkatësisht i juaji, referuar trajtimit respektiv dhe zgjidhjes adekuate të po kësaj çështjeje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuar kryesues i seancës,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë – ministra,

I nderuar deputet Smaka,

Duke ju falënderuar për pyetje, ju informoj se ligji bazë për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin në Kosovë, është Ligji për mbrojtjen e natyrës, i vitit 2006, i aprovuar në Kuvendin e Kosovës dhe të gjitha udhëzimet që dalin nga ky ligj.

Gjithashtu, Kuvendi i Kosovës deri sot ka miratuar ligje që rregullojnë mbrojtjen e natyrës dhe ato që ndërlidhen me veprimtaritë në natyrë, si Ligji për mbrojtjen e natyrës, Ligji për mbrojtjen e mjedisit, gjithashtu ligji i aplikueshëm, Ligji i parkut nacional “Malet e Sharrit” i vitit ‘86, Ligji për planifikimin hapësinor, ndërsa udhëzimet administrative rregullojnë formën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit qendror të zonave

të mbrojtura të natyrës, mënyrën e shënimit të zonave të mbrojtura të natyrës, planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura të natyrës, kriteret dhe procedurat për shfrytëzimin e shpellave, si dhe vendimet për zonat e mbrojtura. Gjithsej në Ministri ekzistojnë 97 vendime për shpalljen nën mbrojtje ligjore. Por, gjithashtu në procedurë ose në Qeveri ose në Parlament janë edhe këto ligje: Ligji i mbrojtjes së natyrës; Ligji i ri, draftimi i Ligjit, Ligji i parkut kombëtar “Malet e Sharrit”, i cili do të ndërrojë ligjin e vjetër, por gjithashtu parashikohet edhe Ligji i parkut kombëtar me mundësi “Bjeshkët e Nemura”. Në qershor të vitit 2004, Qeveria e Kosovës e ka miratuar strategjinë e Kosovës për mjedis. Në mbështetje të këtij dokumentit, gjatë vitit 2006 është hartuar edhe Plan i Kosovës për veprim në mjedis 2006-2010. Po ashtu, strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin, i cili është për periudhën prej vitit 2010 deri më 2020. Mbrojtja e natyrës përmes zonave të mbrojtura është instrument i rëndësishëm ligjor për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetin. Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura përbëhet prej 97 zonave të natyrës, me sipërfaqe afër 46 hektarë ose 4.36% e territorit të Kosovës. Në kuadër të këtyre zonave hynë, si shembull, 11 rezervate të natyrës, bifurkacioni i lumit Nerodime, rezervati i Arnenit, maja e Rovcit, Rusenicë e të tjerë, Parku Kombëtar, Mali Sharr dhe 82 monumente të natyrës, si Shpella....

KRYESUESI: Faleminderit! Keni pyetje shtesë, zoti deputet? Zoti Smaka e ka fjalën!

RIZA SMAKA: Zoti ministër, si mund të shpjegohet, nëse mund të shpjegohet, si mund të tolerohet nëse mund të tolerohet që pikërisht në parqet nacionale, t’i quajmë, në zonat e mbrojtura lulëzojnë ndërtime ilegale, informate, të egra, ju lutem. Ky është një realitet i ithët dhe tash ky bien në kolizion direkt edhe me ato dispozita ligjore që janë në aplikim. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër?

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, është një problem real, për të cilin ne këtu shumë kemi diskutuar, edhe në Raportin mbi gjendjen e mjedisit, por gjithashtu edhe për parkun nacional ose pjesën e Prevallës në Parkun nacional “Malet e Sharrit”. Jemi të gjithë këtu së bashku, edhe si Kuvend, edhe si Qeveri të bëjmë çka është e mundshme, të eliminojmë këto dukuri negative. Ne jemi të gatshëm si Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që me kapacitetet tona të bëjmë të mundshme, të mbrojmë vërtet sipas ligjit zonat e mbrojtura, por gjithashtu edhe mjedisin.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Nerxhivane Dauti, më duket mungon. Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Dokumenti 1858, nuk është. Deputeti Driton Tali, është pyetja e fundit dhe njëkohësisht dëshiroj t’i ftoj deputetët edhe një herë që për shkak të kuorumit të vijnë në sallë ose jemi të detyruar ta ndërpresim seancën. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala, dokumenti 1868. Zoti Tali, e ke fjalën!

DRITON TALI: Pyetja ka të bëjë me forumin e parë investues Kosovë-Mbretëri e Bashkuar, zoti ministër, s’di a e keni. Sa veta morën pjesë nga delegacioni kosovar dhe çka u arrit në atë forum?

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar deputet Tali, me iniciativën dhe bashkë organizimin e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Britaninë e Madhe dhe me Kompaninë angleze Di Locment Market Association, më 24 nëntor në Londër u organizua një konferencë për të cilën sinqerisht dua t'i jap komplimente ambasadorit, Ambasadës dhe kompanisë për një organizim të shkëlqyer. Në bazë të numrit pjesëmarrës, mund të them që Konferenca ka qenë jashtëzakonisht e suksesshme, profili i kompanive, ndoshta numri nuk ka qenë aq i madh, por profili i kompanive ka qenë seriozisht serioz. Disa prej kompanive tanimë janë në kontakte të drejtpërdrejta me disa nga segmentet qofshin qeveritare, qofshin ndërmarrje publike dhe, natyrisht, rezultatet e një konference investuese nuk priten të jenë të matshme në ditët apo javët, por unë jam i sigurt që Kosova është prezantuar mjaft fuqishëm. Unë i përkrah iniciativat e tilla, besoj që ne të gjithë duhet të sforcjohim pak Agjencionin Kosovar për Promovimin e Investimeve dhe do të jem në favor të mbështetjes së çfarëdo projekti që ka të bëjë me prezencën e kosovarëve, prezencën e institucioneve të Kosovës sa më shumë në forumet e tilla, qofshin ato të organizuara nga ambasada, qofshin të organizuara nga ndonjë asociacion tjetër biznesor. Unë shpresoj që në qoftë se në vitin 2010, në të cilin besoj se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka në planin e vet projekte të tilla, do të duhej që edhe institucionet tjera të Kosovës të marrin pjesë për të prezantuar sukseset tona, por edhe potencialet tona zhvillimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Zoti Tali e ka fjalën!

DRITON TALII: Zoti ministër, gjysmë m'u përgjigje, gjysmë jo. Pyetja ishte sa morën pjesë nga delegacioni kosovar. Unë e kam një listë këtu, nga 50 vetë, unë s'di çka kanë bërë këta njerëz atje. Ke nga Aeroporti i Kosovës 8 anëtarë, nga Ministria jote po aq. Keni shkuar, madje edhe asistentet i keni marrë. Po them, këtë zullum as Amerika s'mund ta durojë. Nëse kështu vazhdoni, Kosova sigurisht se nuk do të ecën përpara. Paraja publike nuk bën kështu të shpenzohet. Unë e kam parasysh se ju keni qejf ta shihni Londrën dhe e shfrytëzoni rastin. Edhe një karakteristikë tjetër ishte se të gjitha ndërmarrjet private vetëm nga një delegat e çojnë, nga një pjesëmarrës, gjersa Qeveria shkon me 50 vetë atje, 50-60 veta, kush do t'i paguajë këto?

KRYESUESI: Zoti Shala, e keni fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Driton, unë të paktën asistenten s'e kam marrë me veti, kështu që përndryshe nuk do të duhej as të diskutohej ajo, por secili institucion besoj e ka përzgjedh mënyrën se si të prezantohet vetë. Ne si Qeveri konsiderojmë që përpqemi të paktën mos të përzihejmë shumë në mikromenaxhment në ndërmarrjet publike, ndërsa mund të them se përfaqësimi i Kosovës ka qenë mjaft serioz dhe mjaft dinjitoz edhe në paraqitjet. Aeroporti i Prishtinës, Korporata Energjetike e Kosovës dhe institucionet tjera që janë në vazhden e koncensionimit apo çfarëdo të jetë, duhet të jenë sa më aktive në këtë drejtim. Nuk duhet vetëm Qeveria që të përpqet të shpalosë potencialet ekonomike të Kosovës por edhe ndërmarrjet publike, edhe sektori privat, edhe asociacionet tjera zhvillimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, të nderuar deputetë, konstatoj që edhe pika e dytë e rendit të ditës u ezaurua. Për pikën e tretë të rendit të ditës, ne s’kemi kuorum. Meqenëse s’kemi kuorum, shpresoj se deputetët janë duke ardhur dhe e jap... Janë 52, tash u bënë 55. Atëherë, e jap një pauzë prej 20 minutash. Faleminderit!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Ne mund ta vazhdojmë këtë seancë edhe pse në sallë kemi 52 deputetë, deri te votimi, por nëse nuk na bëhen mbi 60 për votim, ne duhet ta ndërpresim seancën. Pra, debatin mund ta zhvillojmë me 52 deputetë, edhe me 40, por të votojmë s’mund të votojmë. S’e kemi as zëvendëskryeministrin që duhet të na paraqesë ligjin. Ose po e marrim një pauzë, ose po e shtyjmë për javën tjetër. Qeveria po na lajmëron se e kryen mbledhje për 10 minuta dhe vijnë.

A e presim? Mirë. Po, duhet zëvendëskryeministri ta paraqesë ligjin, s’e kemi asnjë nga Qeveria këtu. A po vazhdojmë kështu, në ora 13:00. Deri atëherë po e kryejmë drekën dhe në ora 13:00 kthehemi këtu, po edhe Qeverisë po i themi që të vjen në ora 13:00 këtu. Faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Ju lutem, i zini vendet tuaja! Dëgjoni një herë, se duhet të marrim një vendim. Në sallë kemi 41 deputetë. Kemi 2 pika të rendit të ditës dhe këto 2 pika të rendit të ditës i lëmë për një seancë tjetër.

E mbyll këtë seancë dhe mirë u pafshim në seancën e radhës!

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale